

Republika e Shqipërisë  
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare  
Korçe  
Nr. (597)-00285 regjistri themeltar  
Date 15.07.2015 regjistrimi.



Nr 434-(506) Vendimi  
Date.15.10.2015

**VENDIM**  
**“Ne emër te Republikës”**

Gjykata Administrative e shkalles se pare Korçë, me trup gjykues te përberë prej:

Gjyqtare e vetme: **ETLEVA GJAMO**

Asistuar prej sekretare gjyqësore Viola Palla, ne Gjykatën Administrative te shkalles se Pare Korçë, ne datën 15.10.2015, ora 12:00 mori ne shqyrtim ne seance gjyqësore me detyr te hapura çështjen administrative me nr.(597)-00285 regjistri themeltar, date 15.07.2015 regjistrimi qe i përket palëve:

**PADITES:** Olsi Manosopi, subjekt fizik tregetar, identifikuar me NIPT K74808001F, me seli ne Korçe, Ruga “Nene Tereza” nr 1.

**E PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Korce, perfaqesuar me autorizim nga juriste Mirela Veriga.

**OBJEKTI:** Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim vleresimit date 17.03.2015 per detyrimet tatimore (gjobe për deklarim te vonuar te takses kombetare per muajin Dhjetor 2014) vendosur nga DRT Korçe.

Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim vleresimit date 17.03.2015 per detyrimet tatimore (gjobe per deklarim te vonuar takses kombetare per muajin Janar 2015) vendosur nga DRT Korçe.

Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim vleresimit date 17.03.2015 per detyrimet tatimore (gjobe per deklarim te vonuar takses kombetare per muajin Shkurt 2015 ) vendosur nga DRT Korçe.

Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim vleresimit date 17.03.2015 per detyrimet tatimore (gjobe per deklarim te vonuar Tatim i mbajtur ne burim per muajin Janar 2015) vendosur nga DRT Korçe.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31,32,154 i K.Pr.Civile ligji nr.9920 date 2008 „Per procedurat tatimore ne R.Sh“ dhe udhezimit nr.24 date 02.09.2008 i Ministrit te Financave „Per procedurat tatimore ne R.Sh“ ligji nr.9975 date 28.07.2008 „Per taksat kombetare“, Udhezimi nr.26 date 04.09.2008 „Per taksat kombetare“, ligji nr.8438 date 28.12.1998 „Per tatimin mbi te ardhurat neni 33,35,UMF 5 date 30.01.2006 „Per tatimin mbi te ardhurat,VKM nr.922 date 29.12.2015 „Per deklarimin e

detyrueshem te deklaratave tatimore,udhezimi nr.26 date 16.12.2014  
nenet 116,131 e vijues K.Pr.Administrative,neni 7,17,18 i ligjit  
nr.49/2012.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te paleve, paditesi kerkoi pranimin  
e padise, pala e paditur rrezimin e padise.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe çeshtjen ne teresi .

### VEREN:

Nga aktet bashkangjitur kerkese padise ka rezultuar se paditesi Olsi Manosopi eshte  
rregjistruar si person fizik me NIPT K74808001F, me seli ne Korçe, Ruga "Nene Tereza"  
nr 1, me objekt te veprimtarise "Avokat" .

Ne daten 17.03.2015 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe jane nxjere 4 "Njoftim  
vleresime per detyrimet tatimore", perkatesisht detyrimi gjobe prrej 10 000 leke per  
deklarim te vonuar te takses kombetare per muajt dhjetor 2014, janar 2015 dhe shkurt  
2015 si dhe gjobe ne masen 10 000 leke per deklarim te vonuar te tatimit ne burim per  
muajin janar 2015.

Pasi eshte vene ne dijeni te ketyre detyrimeve nepermjet verifikimit te faqes se tij  
"online", ka paraqitur ankim ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane DPT Tirane, e cila  
me shkresen nr 11 323/1 Prot date 13.05.2015 kerkon prrej tatimpaguesit plotesimin e  
kushteve te ankimit per paraqitjen e "Njoftim vleresimeve " me nenshkrimin dhe vulen e  
drejtorit te DRT Korçe, ne perputhje me percaktimet e nenit 70 te ligjit 9920 date  
19.05.2008 dhe pikes 70.1 te Udhzimit nr 24 date 02.09.2008 ne zbatim te tij.

Paditesi eshte pajisur me Njoftim vleresimet ne formen e kerkuar nga ligji sipas  
shkresave date 15.05.2015 te Drejtorit te DRT Korçe dhe nepermjet sherbimit postar i  
ka percjelle prane Drejtorise se Apelimit Tatimor ne daten 19.05.2015 por kjo e fundit  
nuk e ka mare ne shqyrtim ankesen dhe nuk i ka kthyer paditesit pergjigje zyrtare.

Ne daten 15.07.2015 paditesi paraqet padi ne Gjykaten Administrative te shkalles  
se pare Korçe me te cilen kerkon shfuqizimin e 4 Njoftim vleresimeve date 17.03.2015  
me aresyetimin se jane nxjere ne kundersizim me ligjin.

Lidhur me Njoftim vleresimet per denimin me gjobe per "deklarim te vonuar te  
takses kombetare" per muajt dhjetor 2014, janar 2015 dhe shkurt 2015, paditesi ngre  
pretendimin se taksat kombetare gjejne rregullim ne ligjin nr 9975 date 28.07.2008 "Per  
taksat kombetare" dhe Udhzimin nr 26 date 04.09.2008 ne zbatim te tij ku parashikohet  
edhe menyra e mbledhjes per keto taksa, agjenti tatimor si dhe niveli i tyre.Nderkohe  
referuar ligjit "Per avokatine" paditesi ne cilesine e avokatit nuk eshte subjekt i ligjit per  
taksat kombetare pasi nuk ushtron asnje nga aktivitetet tregetare per te cilat aplikohen  
keto lloj taksash.Vendosja ne sistemin kompjuterik e kesaj takse si detyrim per deklarim  
eshte gabim i pales se paditur pasi paditesi nuk ka kerkuar asnje moment te jete subjekt i  
takses kombetare.

Lidhur me njoftim vleresimin per gjobe ne masen 10 000 leke per deklarim te  
vonuar te "tatimit ne burim" per muajin janar 2015 paditesi ngre pretendimin se ne

veshtrim te VKM nr 922 date 29.12.2014 deklarimi i pergjegjesive tatimore behet vetem online dhe sipas ligjit nr 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" dhe Udhhezimin ne zbatim te tij deklarimi behet brenda dates 20 te muajt pasardhes.

Per muajin janar 2015 paditesi duhet te bente deklarimin deri ne daten 20.02.2015 por e drejta per deklarim online sipas sistemit kompjuterik i eshte njohur ne daten 24.02.2015 dhe paditesi e ka bere deklarimin per muajin janar 2015 ne daten 04.03.2015.

Njoftim vleresimet e Drejtorise Rajonale Ttimore Korçe perfaqesojne akte administrative te pavlefshme pasi aresyet e penalizimit te paditesit jane gabimet e administrates tatimore apo te sistemit kompjuterik tatimor dhe jo veprimet e paditesit.

**Perfaqesuesja e pales se paditur** ne seancen gjyqesore te dates 15.10.2015 kerkoi nga gjykata nxjerrjen e ceshtjes jashte juridiksionit gjyqesor, me aresyetimin se nuk ka perfunduar rruga administrative e ankimit, kerkese e cila nuk u pranua nga Gjykata( dhe vendimi nuk u ankimua nga pala e paditur) , pasi u vleresua se paditesi ka plotesuar te gjitha kushtezimet ligjore per marjen ne shqyrtim te ankimit sipas nenit 106 e e vijues te ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" por Drejtoria e Apelimit tatimor nuk e ka mare ne shqyrtimin ankimin brenda afatit ligjor 60 ditor nga plotesimi i kushtezimeve te ankimit dhe e persa me siper ne veshtrim te nenit 109/2 te ligjit .... Nëse drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë.

Lidhur me aresyet e vendosjes se denimeve me gjobe, perfaqesuesja e pales se paditur prapesoi se me ndryshimet e akteve ligjore dhe nenligjore nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe jane kryer veprime per pershtatjen e sistemit te informatikes me ndryshimet perkatese , çka nenkupton deklarimin on line te pergjegjesive tatimore, perfshire edhe taksat kombetare dhe tatimin ne burim.

Paditesi eshte penalizuar me gjobe per tatimin ne burim (tatimi i qerases) per muajin janar 2015 , detyrim i cili duhet te permbushej brenda dates 20.02.2015 e per kete aresye eshte penalizuar ne zbatim te nenit 113 te ligjit 9920 date 19.05.2008.

Lidhur me 3 njoftim vleresimet per penalizimin me gjobe per deklarim te vonuar te takses kombetare per periudhen dhjetor 2014-janar 2015 , kjo pergjegjesi tatimore ka qene ne rregjistrat tatimore dhe ka kaluar ne sistemin e ri, pra keto ndryshime nuk jane bere mbi kerkesen e tatimpaguesit por jane mare te mireqena ne momentin e pershtatjes se ndryshimeve ligjore me sistemin informatik.

Paditesi nuk eshte subjekt i takses kombetare sipas ligjit nr 9975 date 28.07.2008 "Per taksat kombetare" por ne momentin kur kjo pergjegjesi eshte pasqyruar ne faqen e tij on-line duhet te kishte kerkuar nga DRT Korçe heqjen e kesaj pergjegjesie para dates se detyrimit per te deklaruar.

Ne zbatim te nenit 23 te ligjit 9920 date 19.05.2008 , paditesi eshte njoftuar on-line per celjen e pergjegjesive tatimore te tatimit ne burim dhe takses kombetare per te cilen kishte detyrimin te bente deklarimin e tyre me vleren 0.

Ne kushtet kur njoftim vleresimet jane hartuar konform ligjit ato duhet te lihen ne fuqi.

**Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditesit ne padi dhe gjate gjykimit , prapesimet e pales se paditur dhe provat e sjella prrej tyre, bazuar ne nenin 16 te Kodit te Procedures Civile dhe 17/2 te ligjit 49/2012 , evidenton rrethanat faktike dhe ligjore si me poshte:**

Ne rastin konkret gjykata çmon se konflikti i parashtruar per zgjidhje rrjedh nga nje procedim administrativ dhe per efekt te verifikimit te bazueshmerise ligjore te pretendimeve te paditesit, pervec ligjit te posaçem nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise( i ndryshuar) ku gjejne rregullim ligjor shkeljet qe i atribohen paditesit, do te referoje edhe ne nenin 118 te Kodit te procedurave Administrative qe i referohet rasteve te pavlefshmerise relative te akteve administrative.

a)Lidhur me "Njoftim vleresimin date 17.03.2015" per denimin me gjobe ne masen 10 000 leke per deklarim te vonuar te tatimit ne burim, gjykata mbi pretendimin e paditesit kerkoi prane pales se paditur informacion zyrtar lidhur me faktin se kur ishte bere e aksesueshme faqja zyrtare per deklarimin online te tatimpaguesit Olsi Manosopi dhe DRT Korçe me shkresen nr 16 225 date 15.10.2015 ka konfirmuar pretendimin e paditesit se kjo faqe eshte bere e aksesueshme ne daten 24.02.2015 me efekt qe nga data 01.01.2015.

Ne veshtrim te pikes 5.1 te Udhezimit nr 5 date 30.01.2006 te Ministrit te Financave, dale ne zbatim te ligjit 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" qe i referohet "Mbajtjes se tatimit ne burim" parashikohet se :

*Në zbatim të nenit 33 të Ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjerës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.*

Ne rastin konkret referuar menyres se pageses se detyrimeve sipas ndryshimeve ligjore vetem ne formen on line, paditesi mbart detyrimin per deklarim si me siper por nje deklarim i tille duhet te mundesohet nga organi ne favor te te cilit derdhet detyrimi dhe nga provat e administruara gjate gjykimit gjykates i rezulton se jo per faj te tatimpaguesit ai nuk ka kryer deklarimin e kesaj pergjegjesie ne daten e caktuar ne udhezim, pasi aksesit i tij ka filluar vetem prrej dates 24.02.2015 dhe paditesi ka bere deklarimin ne daten 04.03.2015, pra brenda dates 20.03.2015.

Pavaresisht faktit se efektet e detyrimeve shtrihen para dates 24.02.2015, faqja e paditesit eshte bere e aksesueshme vetem ne daten 24.02.2015 dhe nuk mund te kete fuqi prapavepruese disponimi i administrates tatimore, pasi tatimpaguesit nuk i eshte krijuar mundesia per te bere deklarimin brenda periudhes se parashikuar ne ligj dhe nuk mund te penalizohet me gjobe per deklarim te vonuar.

b)Lidhur me tre njoftim vleresimet date 17.03.2015 per detyrimet tatimore gjobe ne masen 10 000 leke secila per deklarim te vonuar te takses kombetare, gjykata vlereson se pala e paditur ka vepruar ne kundershtrim me ligjin pasi paditesi nuk eshte subjekt i ligjit "Per taksat kombetare" nr 9975 date 28.07.2008 dhe nuk eshte njoftuar per nje pergjegjesi te tille tatimore.

Referuar ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", ne nenin 23 te tij qe i referohet menyrrave te komunikimit me tatimpaguesin parashikohet se:

2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën e deklaruar nga vetë ai:

- a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike ose;
- b) nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

Pra ne interpretim të kesaj dispozite ligjore buron detyrimi i administratës tatimore që të njoftojë tatimpaguesin edhe për ndryshimin e pergjegjesive të tij tatimore pasi ky ndryshim është bërë nga vete administrata tatimore, e cila në veshtrim të nenit 43.2.3 të Udhezimit nr 24 datë 02.09.2008 .... gëzon të drejtën, për të plotësuar në emër të personit të tatueshëm, formularin përkatës të ndryshimeve në regjistrim, ta hedhë atë në sistemin informativ të tatimeve dhe të njoftojë njëkohësisht për këtë si vete personin e tatueshëm ashtu edhe Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe zyrën e taksave të njësisë përkatëse të pushtetit vendor.

Në rastin konkret nëpërmjet nxjerrjes së njoftimit vlerësimeve tatimore dhe njoftimit të tyre online, pala e paditur ka krijuar një pergjegjesi tatimore në llogarinë e tatimpaguesit por gjykates nuk i rezulton që njoftimi i kesaj pergjegjesie tatimore të jetë bërë në përputhje me percaktimet e nenit 23 të ligjit 9920 datë 19.05.2008 lidhur me rregullat e njoftimit elektronik, në lidhje me percaktimet e Udhezimit nr 24 datë 09.12.2014 "Për dhenien e pelqimit dhe menyren e marjes së vlefshmerise e dhenies se pelqimit per komunikimin elektronik te tatimpaguesit me administraten tatimore". Që të quhej i njoftuar subjekti për këtë pergjegjesi tatimore pala e paditur duhet të zgjidhte njerën nga format e njoftimit të komunikimit elektronik të percaktuara në këtë udhëzim.

Në këtë aspekt gjykata vlereson se paditesi ka qenë zyrtarisht i panjoftuar për këtë pergjegjesi tatimore dhe për të nuk mund të linte asnjë pergjegjesi administrative e rjedhimisht nuk mund të penalizohet për deklaram të vonuar përse kohe nuk i është krijuar ligjerisht mundësia për këtë deklaram.

Në kushtet kur subjekti është penalizuar me 4 detyrime gjore në kundërshtim me kriteret ligjore, ka vend që njoftim vlerësimet të shquqizohen si akte relativisht të pavlefshme në përputhje me percaktimet e nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në veshtrim të nenit 45 germa a) të ligjit 49/2012 ky vendim është i paankimueshem pasi sipas kesaj dispozite.... nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare të gjykates administrative per padi me objekt kundërshtimin e denimit per kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlere me të vogël se 20-fishi i pages minimale në shkallë vendi. Në bazë të VKM nr. 573, datë 3.7.2013, "Për percaktimin e pages minimale në shkallë vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e në vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, është 22.000 ( njëzet e dy mijë ) leke.

#### PER KETO ARESYE

Gjykata bazuar në nenin 40-43 dhe 45, a) të ligjit 49/2012

#### VENDOSA

1. Pranimin e padise se paditesit Olsi Manosopi, pale e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, me objekt "Shfuqizim njoftim vleresime per detyrime tatimore" duke u shfuqizuar:  
 -Njoftim vleresimi date 17.03.2015 i DRT Korçe per detyrim tatimor gjobe per deklarim te vonuar te takes kombetare per muajin dhjetor 2014 ne shumen 10 000 lek.  
 -Njoftim vleresimi date 17.03.2015 i DRT Korçe per detyrim tatimor gjobe per deklarim te vonuar te takes kombetare per muajin janar 2015 ne shumen 10 000 lek.  
 -Njoftim vleresimi date 17.03.2015 i DRT Korçe per detyrim tatimor gjobe per deklarim te vonuar te takes kombetare per muajin shkurt 2015 ne shumen 10 000 lek.  
 -Njoftim vleresimi date 17.03.2015 i DRT Korçe per detyrim tatimor gjobe per deklarim te vonuar te tatimit te mbajtur ne burim per muajin janar 2015 ne shumen 10 000 lek, si akte ne kundershtrim me ligjin.
2. Shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke I ngarkohen pales se paditur.
3. Ky vendim eshte perfundimtar dhe kunder tij nuk lejohet ankim.

U shpall ne Korce date 15.10.2015

SEKRETARE  
Viola Palla



GJYQTARE  
ETLEVA GJAMO

VENDIMI KA MARRE  
FORME TE PRERE  
NE DATE 15.10.2015  
KORCEME 15.10.2015  
KANCELAR

*Handwritten signature*

